

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J

Nr.9875, datë 14.2.2008

PËR METROLOGJINË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

**K R E U I
D I S P O Z I T A T Ë P Ë R G J I T H S H M E**

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon sistemin kombëtar të metrologjisë në Shqipëri dhe kërkesat për të kryer veprimtaritë në metrologjinë shkencore, industriale dhe atë ligjore.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka si qëllim të realizojë:

- a) zhvillimin e sistemit kombëtar të metrologjisë, në përputhje me kërkesat ndërkombëtare dhe me nevojat kombëtare;
- b) njohjen ndërkombëtare të rezultateve të matjeve kombëtare dhe të etaloneve kombëtare të matjeve;
- c) lëvizjen e lirë të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, nëse këto instrumente kanë shenjën e miratimit të tipit dhe të verifikimit fillestar ose, në mungesë të këtij të fundit, lejimin për hedhjen në treg ose vënien në shërbim të tyre;
- ç) lëvizjen e lirë të produkteve të parapaketuara, nëse ato kanë shenjën e konformitetit dhe harmonizimin e metodave për matjet dhe kontrollin metrologjik;
- d) mbrojtjen e konsumatorëve dhe të shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Instrument matës" është çfarëdo pajisje apo sistem me funksione matëse.
2. "Metrologji" është shkencë e matjeve.
3. "Metrologji shkencore" është ajo pjesë e metrologjisë, e cila merret me realizimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e etaloneve kombëtare të matjeve.
4. "Metrologji industriale" është pjesë e metrologjisë, me të cilën realizohet krahasimi i rezultateve të matjes.
5. "Metrologji ligjore" është pjesë e metrologjisë, e cila rregullohet me ligj dhe dispozita të tjera, për sigurimin e saktësisë dhe të besueshmërisë në rezultatet e matjes në fushat ku aplikohen instrumente matëse ligjorisht të kontrolluara.
6. "Matje" është seria e veprimeve për përcaktimin e vlerës së një madhësie.
7. "Njësi matjeje" është madhësia e caktuar, e pranuar me marrëveshje, për të shprehur në mënyrë sasiore madhësi të tjera të së njëjtës natyrë.
8. "Tipi i instrumentit matës" është një seri instrumentesh matëse, me funksion identik, bazuar në të njëjtin parim, që kanë të njëjtin projekt dhe që janë prodhuar nga i njëjti prodhues, në bazë të të njëjtit dokumentacion teknik dhe teknologjik.
9. "Etalon matjeje" është masë matjeje, instrument matës, material referues ose sistem matës i paracaktuar që të përcaktojë, të realizojë, të ruajë ose të riprodhojë një njësi ose më shumë vlera të një madhësie, për t'i transmetuar ato, me anë të krahasimeve, me instrumente të tjera matëse.
10. "Etalon kombëtar i matjeve" është një etalon i deklaruar nga Këshilli i Ministrave për të shërbyer në Republikën e Shqipërisë si një bazë për përcaktimin e vlerave të etaloneve të tjera të madhësisë përkatëse.
11. "Etalon referues" është një etalon që, përgjithësisht, ka cilësinë më të lartë metrologjike në një vend apo organizatë të dhënë, nga i cili rrjedhin matjet e bëra.
12. "Ruajtje e etalonit të matjes" janë të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur karakteristikat metrologjike të etalonit të matjes, brenda kufijve të caktuar.
13. "Material referues" është një material mjaftueshmërisht homogjen dhe i qëndrueshëm, për një apo më shumë cilësi, i përdorur në kalibrim, për përcaktimin e vlerës së një materiali tjetër ose për sigurimin e cilësisë.
14. "Material referues i certifikuar" është një material referues, i shoqëruar me dokumentacionin e lëshuar nga organizma autoritarë dhe në përputhje me procedurat e vlefshme, të përdorura për të shtuar vlera cilësore specifike me pasiguri dhe transmetueshmëri (gjurmueshmëri).
15. "Transmetueshmëri (gjurmueshmëri)" është cilësia e rezultatit të matjes ose vlera e etalonit të matjes, e arritur pas një serie zinxhiri krahasimesh me etalonet e përcaktuara të matjes, ndërkombëtare ose kombëtare, që kanë të gjitha një pasiguri dhe nivel besueshmërie të përcaktuar.
16. "Kalibrim" është tërësia e veprimeve që përcakton, në kushte të veçanta, marrëdhënien ndërmjet vlerave të treguara nga një instrument ose sistem matës, ose të vlerave të dhëna nga një masë materiale, si dhe të vlerave të njohura, korresponduese të instrumentit të matur.
17. "Verifikim" është konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike.
18. "Verifikim i rregullt i një instrumenti matës" është një verifikim i kryer periodikisht dhe në përputhje me rregullat.
19. "Verifikim jashtë radhe i instrumentit matës" është një verifikim i kryer pas rimodelimit, eliminimit të mosfunksionimeve ose defekteve të tjera teknike (riparim) apo i kryer jashtë periudhës së verifikimit.

20. “Autorizim” është dhënia e së drejtës për të kryer shërbime të metrologjisë ligjore të instrumenteve matëse në sferën e detyrueshme, subjekteve publike dhe private, vendase ose të huaja, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

21. “Certifikim” është veprimtaria, nëpërmjet së cilës një palë e tretë dhe e pavarur dëshmon zyrtarisht se një produkt, proces apo shërbim është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimet metodike të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ose në përputhje me standardet e përcaktuara.

22. “Parapaketim” është kombinimi i një produkti dhe një paketimi individual. Një produkt është i paketuar, kur ai vendoset në parapaketim të çfarëdo natyre qoftë, pa qenë blerësi prezent dhe sasia e produktit, që përmbahet në parapaketim, ka një vlerë të paracaktuar dhe nuk mund të ndryshohet pa u hapur parapaketimi ose pa iu nënshtruar një modifikimi të perceptueshëm.

23. “Shishe, si enë matëse” është çfarëdo kontejneri i bërë prej qelqi ose ndonjë materiali tjetër, që ka një fortësi dhe qëndrueshmëri të tillë, për të ofruar të njëjtat garanci metrologjike si qelqi, i taposur apo i projektuar për t'u taposur, që destinohet për magazinim, transport ose shpërndarje të lëngjeve e që ka karakteristika metrologjike (karakteristika të projektimit dhe uniformitet të prodhuesit) të tilla, që mund të përdoren si shishe matëse, kur ato mbushen deri në një nivel specifik ose një përqindje të specifikuar të kapacitetit të tyre deri në buzë dhe përmbajtja e tyre mund të matet me një saktësi të mjaftueshme dhe që ka kapacitet nominal nga 0,05 deri në 5 litra brenda.

24. “Inspektim” është shqyrtimi i një produkti, shërbimi, procesi ose sistemi matës, me anë të përcaktimit të përputhjes së tyre me kërkesat specifike ose në bazë të një gjykimi profesional, me kërkesa të përgjithshme.

25. “Matje zyrtare” është një matje e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar (më poshtë ekzekutues i matjes zyrtare), në përputhje me vendimin administrativ për autorizim. Matja zyrtare përdoret si evidencë e besueshme në procedurat dhe vendimmarrjet e organizmave qeveritarë apo të gjykatave.

26. “Miratim i tipit të instrumenteve matëse” është pranimi i këtyre instrumenteve për verifikim fillestar dhe, kur kjo e fundit nuk kërkohet, autorizimi për t'i hedhur ato në treg dhe/ose për t'i vënë në shërbim.

27. “Verifikim fillestar i instrumenteve matëse” është kontrolli i një instrumenti të ri apo të riparuar dhe vërtetimi i përputhjes së instrumentit matës me tipin e miratuar.

28. “Lejim për hedhje në treg ose vënie në shërbim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara” është leja e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për hedhjen në treg ose vënien në shërbim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, të cilat nuk kanë shenjën e verifikimit fillestar.

Neni 4
Fushat e zbatimit

Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen në ato instrumente matëse, që përdoren për matje në transaksionet tregtare dhe zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 5
Vënia në dispozicion të publikut e rezultateve të matjeve

Rezultatet e matjeve, të kryera me kërkesë të organizmave qeveritarë ose që i shërbejnë nevojave të organizmave qeveritarë dhe që kanë lidhje me transaksionet zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit, duhet të vihen në dispozicion të publikut, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

KREU II
ORGANIZIMI I SISTEMIT KOMBËTAR TË METROLOGJISË

Neni 6
Sistemi kombëtar i metrologjisë

Sistemi kombëtar i metrologjisë përbëhet nga:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;
- b) laboratorët e etaloneve kombëtare;
- c) laboratorët e kalibrimit;
- ç) laboratorët e testimit;
- d) organizmat certifikues, që merren me certifikimin e materialeve referuese në fushën e metrologjisë;
- dh) personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, për të kryer detyra të metrologjisë ligjore, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 7
Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është person juridik, publik, i specializuar për metrologjinë, me qendër në Tiranë dhe e organizuar në qendra rajonale, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë.

2. Juridiksioni i ushtrimit të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë është i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë, ndërsa për qendrat rajonale territori përcaktohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme e Metrologjisë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë. Rekrutimi i nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

4. Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë

rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Detyrat dhe të drejtat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka këto detyra e të drejta për metrologjinë:

1. Propozon strategjinë e zhvillimit të metrologjisë dhe, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, ndjek zbatimin e saj nëpërmjet ministrit përgjegjës për ekonominë.
2. Studion dhe propozon përmirësime të legjislacionit për metrologjinë, të cilat ia paraqet ministrit përgjegjës për ekonominë.
3. Bashkërendon punën me organizmat e tjerë të sistemit kombëtar të metrologjisë dhe mbështet zhvillimin e këtij sistemi kombëtar.
4. I propozon ministrisë përgjegjëse për ekonominë deklarin e mbajtësve të etaloneve kombëtare të matjeve.
5. Mban dhe ruan disa nga etalonet kombëtare të njësive të matjes në laboratorët e saj.
6. Monitoron mënyrën e mbajtjes, të ruajtjes dhe të përdorimit për të gjitha etalonet kombëtare të matjeve.
7. Monitoron përdorimin e fondeve shtetërore, për financimin e etaloneve kombëtare të matjeve në institucionet e tjera publike dhe private.
8. Certifikon materialet referuese.
9. Kryen kontrollin ligjor të instrumenteve matëse.
10. Kryen kontrollin sasior të produkteve të parapaketuara dhe të shisheve, si enë matëse.
11. Përcakton procedurën e mbajtjes së regjistrit të prodhuesve dhe të importuesve të parapaketimeve dhe shisheve, enë matëse.
12. Autorizon persona juridikë për verifikimin e mjeteve matëse, ekspertizën metrologjike, si dhe persona fizikë apo juridikë për riparimin e instrumenteve matëse.
13. Realizon inspektimin metrologjik.
14. Kryen mbikëqyrjen e tregut të instrumenteve matëse, të prodhuara në vend dhe/ose të importuara, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.
15. Sanksionon rregullat dhe mënyrën për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të saj dhe ofron kualifikime për çështje të metrologjisë për specialistët e tjerë të subjekteve private dhe publike.
16. Bashkëpunon me institucionet e tjera, veçanërisht me ato të infrastrukturës kombëtare të cilësisë dhe institucionet e mbrojtjes së konsumatorit.
17. Shërben si referencë kombëtare për sistemin kombëtar të akreditimit të laboratorëve të kalibrimit, për aftësitë dhe etalonet e matjeve.
18. Përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë të metrologjisë.
19. Bashkëpunon me organizmat kombëtarë të metrologjisë të vendeve të tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë në veprimtarinë e fushës përkatëse, rajonale apo ndërkombëtare, ose për të arritur marrëveshje dypalëshe.
20. Ofron këshillime për problemet që kanë lidhje me legjislacionin për metrologjinë.
21. Kryen verifikimin periodik të lojërave të fatit.

Neni 9

Detyrat e institucioneve kryesore

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, që kanë në varësi laboratorë matjeje, mbështesin veprimtarinë e strukturave, që kanë në varësi, për të siguruar transmetueshmëri (gjurmueshmëri), saktësi dhe besueshmëri në procesin e matjeve.

Neni 10

Këshilli i metrologjisë

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë krijohet dhe funksionon këshilli i metrologjisë, i cili është organ këshillimor i Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtij organi përcaktohen me urdhër ministrit përgjegjës për ekonominë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm kësaj drejtorie.

KREU III NJËSITË E MATJES

Neni 11

Në Republikën e Shqipërisë do të përdoret Sistemi Ndërkombëtar i Njësive të Matjes (SI).

Këshilli i Ministrave bën përcaktimin e njësive të tjera jashtë sistemit SI dhe përcakton përdorimin e njësive jashtë sistemit SI, kur ato përdoren ndërkombëtarisht dhe nuk rrjedhin drejtpërdrejt nga sistemi SI.

KREU IV
METROLOGJIA SHKENCORE DHE INDUSTRIALE

PJESA I
METROLOGJIA SHKENCORE

Neni 12
Etalonet kombëtare të matjeve

1. Mbajtësit e etaloneve kombëtare të matjeve deklarohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

2. Etalonet kombëtare të matjeve duhet të jenë të transmetueshme (gjurmueshme) me etalonet ndërkombëtare.

3. Jo çdo madhësi fizike duhet të ketë etalonin kombëtar të matjeve të deklaruar.

4. Etalonet kombëtare të matjeve zhvillohen dhe mirëmbahen në laboratorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Për ato madhësi fizike që kjo drejtori nuk ka kapacitete matjeje, etalonet kombëtare zhvillohen dhe mirëmbahen në institucione të tjera publike apo private.

5. Zhvillimi, mirëmbajtja dhe njohja ndërkombëtare e etaloneve kombëtare të matjeve paraqesin interes të veçantë për Republikën e Shqipërisë dhe mbështeten nga fondet e Buxhetit të Shtetit.

6. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për:

a) kushtet që duhet të plotësojë një etalon referues për t'u deklaruar si etalon kombëtar matjeje;

b) kushtet për anulimin e deklarimit dhe arsyet;

c) mirëmbajtjen e detyrueshme dhe përdorimin e etaloneve kombëtare të matjeve.

Neni 13
Laboratorët e etaloneve kombëtare

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe personat juridikë e fizikë që zhvillojnë, mirëmbajnë dhe përdorin etalonet kombëtare të matjeve, kryejnë detyrat e laboratorit të etaloneve kombëtare për madhësinë përkatëse, si më poshtë:

a) sigurimin e transmetueshmërisë (gjurmueshmërisë) së etaloneve kombëtare të matjeve me njësitë SI;

b) përhapjen e njësive të etaloneve kombëtare të matjeve tek etalonet referuese të matjeve dhe të instrumenteve matëse me anë të kalibrimit;

c) sigurimin e njohjes ndërkombëtare të etaloneve kombëtare të matjeve dhe të certifikatës të kalibrimit të lëshuar;

ç) ndërmarrjen e masave për ruajtjen e transmetueshmërisë (gjurmueshmërisë), në rastin e dëmtimit dhe të shkatërrimit të etaloneve kombëtare të matjeve.

2. Aftësia teknike e laboratorëve të etaloneve kombëtare të matjeve ruhet nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtaritë metrologjike ndërkombëtare dhe provohet me akreditim apo në një mënyrë tjetër të barasvlefshme.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë bashkërendon veprimtaritë e laboratorëve të etaloneve kombëtare të matjeve drejt njohjes ndërkombëtare.

4. Marrëdhëniet ndërmjet laboratorëve të etaloneve kombëtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe personave juridikë apo fizikë rregullohen me kontratë.

5. Laboratorët e etaloneve kombëtare duhet t'i dërgojnë Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë të dhëna për veprimtaritë me etalonet kombëtare të matjeve, përfshi edhe të dhënat për përdorimin e fondeve buxhetore në bazë të kontratës së hartuar mes tyre.

PJESA II METROLOGJIA INDUSTRIALE

Neni 14

Transmetueshmëria (gjurmueshmëria) e matjeve

Transmetueshmëria (gjurmueshmëria) e mjeteve matëse sigurohet me anë të kalibrimit ose me materialet referuese të certifikuara.

Neni 15

Kalibrimi i etaloneve të matjes dhe instrumenteve matëse

1. Kalibrimi kryhet në përputhje me dokumentet dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare për standardizimin, akreditimin dhe metrologjinë.

2. Kalibrimi i etaloneve të matjeve dhe instrumenteve matëse kryhet në laboratorët e kalibrimit, me kërkesën e përdoruesit.

3. Aftësia teknike e laboratorëve të kalibrimit provohet me akreditim.

Neni 16

Certifikimi i materialeve referuese

1. Certifikimi i materialeve referuese është një procedurë, që vendos një apo më shumë cilësi të vlerave të një materiali ose substance, me një proces që siguron transmetueshmërinë (gjurmueshmërinë) ndaj SI-së. Cilësitë e vendosura të vlerave dhe pasiguritë shoqëruese të matjeve paraqiten në një certifikatë.

2. Certifikimi i materialeve referuese kryhet në përputhje me procedurat e miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

3. Testimi i cilësive të materialeve referuese kryhet nga laboratorët e testimit.

4. Certifikimi i materialeve referuese kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe organizma të tjerë certifikimi, të përcaktuar sipas dispozitave në fuqi.

5. Aftësia teknike e laboratorëve të testimit të materialeve referuese dhe të organizmave të certifikimit provohet me akreditim.

Neni 17

Detyrat e laboratorëve të etaloneve kombëtare për të mbështetur transmetueshmërinë (gjurmueshmërinë) e matjeve

1. Laboratorët e etaloneve kombëtare ofrojnë kalibrime të etaloneve referuese të matjeve të laboratorëve të kalibrimit me kërkesën e tyre.

2. Laboratorët e etaloneve kombëtare sigurojnë vlerat referuese të njëjësive respektive të matjeve për krahasimet ndërlaboratorike, të organizuara për laboratorët e kalibrimit.

KREU V

METROLOGJIA LIGJORE

PJESA I

Neni 18

Instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Sipas këtij ligji, instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara janë instrumentet matëse që përdoren në:

a) transaksionet tregtare dhe zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik dhe sigurinë;

b) kontrollin e produkteve të parapaktuara dhe shisheve, si enë matëse;

c) matjet e përshkruara nga ky ligj dhe rregulla të përshtatura për zbatimin e tyre.

2. Instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, ashtu si dhe përbërësit e tyre, pajisjet shtesë dhe pajisjet ndihmëse, i nënshtrohen kontrollit metrologjik, që kryhet nëpërmjet miratimit të tipit, verifikimit fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matëse.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për kërkesat teknike dhe metrologjike, për instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 19

Hedhja në treg dhe/ose vënia në përdorim e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara mund të hidhen në treg dhe/ose të vihen në përdorim, nëse janë testuar sipas një procedure të përshkruar, përputhen me rregullat metrologjike dhe kanë shenjat verifikuese të përshkruara.

2. Instrumentet matëse, që janë hedhur në treg dhe/ose janë vënë në shërbim, në përputhje me rregulla të tjera, mund të përdoren në metrologjinë ligjore, nëse ato kanë kaluar procedurat e përshkruara të vlerësimit të konformitetit, plotësojnë kërkesat thelbësore të përshkruara dhe kanë shenjën e përshkruar të përputhjes, me të cilën një prodhues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar (më poshtë referuar si furnitor) garanton se instrumentet matëse përputhen me kërkesat metrologjike të përshkruara.

Neni 20

Përdorimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, që janë përdorur në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duhet të përputhen me tipin e miratuar dhe/ose kërkesat teknike dhe metrologjike të jenë verifikuar dhe të kenë të fiksuara shenjat e vlefshme të përshkruara.

2. Një instrument matës ligjërish i kontrolluar, që nuk është në përdorim, duhet të jetë i markuar, në mënyrë të dukshme, me shenjën “instrument matës jashtë përdorimit”.

3. Personat juridikë dhe fizikë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, duhet të përdorin instrumente matëse ligjërish të kontrolluara, në mënyrë që të sigurojnë saktësinë e kërkuar të matjeve. Ata janë përgjegjës për performancën teknike të instrumenteve matëse dhe për saktësinë e rezultateve të matjeve.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përshkruan markimin e instrumenteve matëse, që nuk përdoren më në metrologjinë ligjore.

Neni 21

Detyrimet e përdoruesve të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara në përdorim

Përdoruesi i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara duhet që:

- a) të përdorë instrumente matëse të verifikuara;
- b) t'i mirëmbajë ato në kushte teknike, që sigurojnë saktësinë e matjeve;
- c) t'i verifikojë sipas këtij ligji dhe rregullave të përshtatura për zbatimin e tij;
- ç) t'i përdorë sipas qëllimit të tyre;
- d) të mbajë regjistrime për mirëmbajtjen dhe verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara në përdorim, kur kështu është e përshkruar.

Neni 22

Miratimi i tipit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë miraton tipin e instrumentit matës, kur ky plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike, të përshkruara në rregulloren e Këshillit të Ministrave, për kërkesat teknike dhe metrologjike, për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, sipas pikës 3 të nenit 18 të këtij ligji.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë merr vendim për refuzimin apo heqjen e instrumentit matës, kur ky instrument nuk plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike të kërkuara, të përcaktuara për një procedurë testimi.

3. Kundër vendimit për refuzimin ose heqjen e instrumentit matës mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

4. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr një rregullore për miratimin e tipit të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara.

Neni 23

Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara

1. Nëse është përcaktuar, nëpërmjet procedurave testuese të përshkruara, se instrumenti matës ligjërish i kontrolluar përputhet me tipin e miratuar dhe plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike të përshkruara, një metrolog i autorizuar e verifikon atë.

2. Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara mund të jetë fillestar, periodik, i kryer në intervale specifike dhe jashtë radhe.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar është i detyruar të lëshojë certifikatën e verifikimit me kërkesën e aplikantit, edhe nëse instrumenti matës ka të fiksuar tashmë shenjën e verifikimit.

4. Instrumentet matëse, që nuk janë subjekt i verifikimit, duhet të mirëmbahen rregullisht. Procedura, përmbajtja dhe intervalet, kur kryhet mirëmbajtja e rregullt, rekomandohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

5. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr një rregullore për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 24

Mbarimi i vlefshmërisë së verifikimit

Verifikimi i një instrumenti matës ligjërisht të kontrolluar nuk është i vlefshëm nëse:

- a) ka mbaruar periudha e verifikimit;
- b) instrumenti matës i nënshtrohet një modifikimi, që ndikon në karakteristikat e tij metrologjike;
- c) instrumenti matës është dëmtuar në një mënyrë të tillë, që ai humbet disa karakteristika të tij thelbësore të verifikimit të mundshëm ose qëllimin e tij të përdorimit;
- ç) shenja e verifikimit është shkatërruar;
- d) është e qartë se instrumenti matës ka humbur karakteristikat metrologjike të kërkuara, megjithëse shenja e verifikimit nuk është dëmtuar;
- dh) vendi i instalimit të instrumentit matës është ndryshuar.

Neni 25

Verifikimi fillestar i instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar

1. Instrumentet matëse, që janë me tip të miratuar, i nënshtrohen verifikimit fillestar, vetëm nëse është përshkruar ndryshe.

2. Verifikimi fillestar i instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar është përgjegjësi e furnitorit. Verifikimi fillestar ka të bëjë me kontrollin e instrumentit matës të ri ose të riparuar dhe vërtetimin e përputhshmërisë së tij me tipin e miratuar. Ky instrument matës ligjërisht i kontrolluar certifikohet me shenjën e verifikimit fillestar.

3. Kur instrumenti matës i nënshtrohet verifikimit fillestar, kontrolli duhet të përcaktojë nëse:

- a) instrumenti i përket një kategorie të përjashtuar nga tipi i miratuar dhe, në këtë rast, nëse përmbush kërkesat teknike dhe funksionale;
- b) instrumenti matës është i tipit të miratuar dhe në përputhje me të.

4. Instrumentet matëse, që janë hedhur në treg, i nënshtrohen verifikimit fillestar, kur përdoren në metrologjinë ligjore.

Neni 26

Verifikimi pasardhës i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Verifikimi periodik i instrumenteve matëse bëhet në intervale verifikimi të

përshkuara për tipe të ndryshme instrumentesh matëse.

2. Verifikimi periodik i instrumenteve matëse është përgjegjësi ligjore e përdoruesit/pronarit të tij.

3. Verifikimi periodik i instrumenteve matëse, si matësit e ujit të ngrohtë apo të ftohtë, matësit e energjisë elektrike dhe të gazit janë përgjegjësi ligjore e personave juridikë apo fizikë, që shesin ujin e ftohtë apo të ngrohtë, gazin dhe energjinë elektrike.

4. Verifikimi jashtë radhe i instrumenteve matëse kryhet kur ky instrument nuk ka qenë në përdorim për prishje apo defekte të tjera teknike ose nuk është verifikuar brenda periudhës së përshkruar të verifikimit.

Neni 27

Vendi i verifikimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar kryejnë verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara në kushtet e veta dhe në vendet e verifikimit.

2. Vendi i verifikimit është vendi jashtë kushteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose të një personi juridik të autorizuar, ku këto të fundit kryejnë verifikimin e një tipi të veçantë instrumenti matës ligjërisht të kontrolluar, duke përdorur pajisjet e përshkuara, që i përkasin kësaj drejtorie, personit juridik të autorizuar, përdoruesit të instrumentit matës apo shërbimit të autorizuar.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar kryen verifikimin e instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në vendet ku janë vendosur, ndërftuar apo instaluar instrumentet matëse, në rastet kur një instrument matës ligjërisht i kontrolluar, për shkak të konstruksionit, është i lidhur me vendin e instalimit, ose në raste të instrumenteve matëse që, për shkak të konstruksionit të tyre, mund të dëmtohen apo thyhen gjatë transportit.

4. Kur kryhet verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, sipas pikës 3 të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar mund t'i kërkojë kërkuarit numrin e duhur të personelit ndihmës dhe pajisje verifikuese.

Neni 28

Shenjat (markimet) e verifikimit

1. Shenjat e verifikimit, të përdorura në Republikën e Shqipërisë, janë shenjat shtetërore të verifikimit për verifikimin fillestar dhe atë pasardhës.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përcakton tipin, formën dhe fiksimin e shenjave të verifikimit, të përdorura për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës së verifikimit.

Neni 29

Përdorimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të riparuar

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përcakton se:

a) një instrument matës i riparuar mund të përdoret brenda një periudhe së shumti 30-ditore, duke filluar nga dita që ai është riparuar ose përgatitur për verifikim;

b) një person i autorizuar për të kryer veprimtari metrologjike përgatit si duhet instrumentin matës për verifikim, e teston dhe mbron nga ndërhyrja e paautorizuar, nëpërmjet markimit me shenjën e verifikimit të shërbimit të autorizuar.

2. Personi i autorizuar për të kryer veprimtari metrologjike riparimi duhet të bëjë menjëherë një kërkesë për verifikimin e instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, të riparuar, i cili është shenjuar me shenjën e verifikimit të personit të autorizuar.

Neni 30

Etalonet e matjeve dhe materialet referuese në metrologjinë ligjore

1. Për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara duhet të përdoren vetëm etalone matjeje të kalibruara, që kanë certifikatë kalibrimi të vlefshme dhe materiale referuese të certifikuara, që kanë certifikatë materiali referues të vlefshëm.

2. Kalibrimi i etaloneve të matjeve dhe certifikimi i materialeve referuese, që përdoren për verifikimin e instrumenteve ligjërisht të kontrolluara, kryhet nga Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë, organizma të tjerë certifikimi, laboratorë kalibrimi të akredituar dhe laboratorë testimi të akredituar.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë rekomandon intervalet e kalibrimit për etalonet e matjes, që përdoren për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 31

Certifikatat dhe shenjat e konformitetit të instrumenteve matëse, të lëshuara jashtë shtetit

1. Republika e Shqipërisë njeh certifikatat dhe shenjat e konformitetit, të lëshuara jashtë vendit, nëse ato janë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë mund të pranojë raportet e testimit dhe të verifikimit, nëse ato janë lëshuar sipas kërkesave të Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë mban një regjistër të certifikatave, shenjave të konformitetit, të lëshuara në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 32

Verifikimi i sistemeve matëse

1. Verifikimi periodik dhe jashtë radhe i sistemeve matëse përfshin verifikimin e një instrumenti matës ligjërisht të kontrolluar e të një pjese përbërëse të sistemit, si dhe verifikimin e sistemit si i tërë.

2. Pjesët e sistemit, që nuk ndikojnë në performancën metrologjike të sistemit, përjashtohen nga kontrolli metrologjik.

3. Verifikimi i instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, si pjesë e sistemit matës dhe verifikimi i sistemit matës si i tërë është përgjegjësi e përdoruesit/pronarit të sistemit matës.

Neni 33

Pajisje me funksione matëse

Pajisjet me funksione matëse, që janë ekzaminuar, testuar dhe vlerësuar, në përputhje me rregulla të tjera, janë subjekt i dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të përshtatura për zbatimin e tij, që rregullojnë trasmetueshmërinë (gjurmueshmërinë) e etaloneve të matjeve, materialeve referuese dhe të rezultateve të matjeve.

PJESA II

EKSPERTIZA METROLOGJIKE

Neni 34

1. Veprimtaritë e ekspertizës metrologjike janë: testimi i jashtëzakonshëm i instrumenteve matëse dhe matjet zyrtare.

2. Personat fizikë apo juridikë kanë të drejtë të kërkojnë që Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose një person juridik i autorizuar të kryejë një testim të jashtëzakonshëm të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar në përdorim dhe të hartojë një raport testimi, kur dyshohet për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar.

3. Kostot që dalin gjatë testimit të jashtëzakonshëm të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara do të paguhet nga:

a) kërkuesi, në rastin kur instrumenti ka shenjë e verifikimit të vlefshme dhe nga testimi rezulton në përputhje me kërkesat metrologjike;

b) përdoruesi i instrumentit matës, kur nga testimi rezulton jo në përputhje me kërkesat metrologjike.

4. Personi juridik i autorizuar, për të bërë matje zyrtare, harton një raport testimi për rezultatet e matjes.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përshkruan përmbajtjen dhe procesin e një ekspertize metrologjike, në të dy komponentët e saj.

PJESA III PARAPAKETIMET DHE SHISHET

Neni 35

Parapaketimet e kontrolluara ligjërisht

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në parapaketimet njëshe, të kombinuara, pa ambalazh mbështjellës dhe në enë matëse, që janë prodhuar, hedhur në treg ose ofruar për shitje te një blerës i panjohur.

2. Mostrat e lira, disa nga parapaketimet e destinuara, të përdorura në aeroplane, anije dhe trena dhe produktet në kontejnerë, që janë përgatitur për konsumatorin e fundit, në bazë të një kontrate të ndërsjellë, nuk vlerësohen parapaketime, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë rregulloren për parapaketimet, ku përshkruhen:

- a) kriteret, parimet kryesore dhe masat e përgjithshme për parapaketimet;
- b) parapaketimet që kontrollohen ligjërisht;
- c) kërkesat metrologjike për sasinë neto të parapaketimeve;
- ç) diapazonet e detyrueshme për sasinë nominale të disa parapaketimeve;
- d) metodat referuese për kontrollin e sasisë neto të parapaketimeve;
- dh) mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në parapaketime.

Neni 36

Shishet, si enë matëse, ligjërisht të kontrolluara

1. Sipas këtij ligji, shishe, si enë matëse, është një enë prej qelqi ose ndonjë materiali tjetër, që ruan formën e saj të pandryshueshme, në përputhje me kërkesat metrologjike të përshkuara, kapaciteti nominal i të cilave është nga 0,05 - 5 litra, përfshirë dhe këto dy vlera.

2. Shishet, si enë matëse, duhet të pajisen me shenja që tregojnë vëllimin nominal dhe atë të mbushjes deri në buzë, si dhe me shenjë që identifikon prodhuesin e enës matëse.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë rregulloren për shishet, si enë matëse, ku do të përshkruhen:

- a) shishet, që kontrollohen ligjërisht;
- b) kërkesat metrologjike për shishet, si enë matëse;
- c) metodat referuese për kontrollin e vëllimit neto të shisheve;

ç) mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në shisheet, si enë matëse.

Neni 37

Hedhja në treg e parapaketimeve dhe e shisheve

1. Mallrat e paketuara dhe shisheet, si enë matëse, mund hidhen në treg dhe të ofrohen për shitje, vetëm nëse plotësojnë kërkesat metrologjike të përshkruara dhe kanë mbishkrimet dhe shenjat e përshkruara deri në kohën e blerjes.

2. Prodhuesi ose importuesi është përgjegjës për përputhshmërinë e produkteve të paketuara dhe të shisheve me masat e përcaktuara në këtë ligj.

3. Prodhuesi zbaton sistemin e tij të kontrollit të sasisë neto të paketimeve ose sistemin e kontrollit të vëllimit neto të shisheve të prodhuara.

4. Prodhuesi ose importuesi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, kur vihet re se parapaketimet ose shisheet e hedhura në treg prej tij nuk përmbushin kërkesat, është i detyruar të marrë masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 38

Regjistrimi i prodhuesve dhe i importuesve

Regjistrimi i prodhuesve dhe i importuesve bëhet në bazë të kërkesës së tyre nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, sipas kërkesave dhe procedurave të miratuara nga ministri përgjegjës për ekonominë. Prodhuesit dhe importuesit detyrohen të njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për çdo ndryshim të kryer pas regjistrimit.

Neni 39

Miratimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë kryen vëzhgimin në vend të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve, që kanë bërë kërkesë për miratim, si dhe monitoron sistemin e kontrollit sasior të miratuar në kushtet e prodhuesit dhe, në qoftë se është e nevojshme, jep rekomandime për përmirësimin e tij.

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë nuk e miraton ose miraton pjesërisht sistemin e kontrollit sasior të prodhuesit, nëse ai nuk mirëmbahet si duhet.

Regjistrimi i prodhuesve bëhet dhe ruhet vetëm nëse sistemi i tij i kontrollit sasior është miratuar.

PJESA IV DHËNIA E AUTORIZIMIT

Neni 40

Autorizimi i personave juridikë dhe fizikë për të kryer veprimtari në metrologjinë ligjore

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë jep autorizimin, në përputhje me këtë ligj dhe me rregulloret e nxjerra në zbatim të tij.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë mund të autorizojë një person juridik, që plotëson kushtet e përshkruara, për të realizuar verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara dhe ekspertizën metrologjike, kur kjo drejtori nuk ka mundësi t'i realizojë këto detyra.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë mund të autorizojë një person juridik apo fizik për shërbimin e riparimit të instrumenteve matëse. Shërbimi i riparimit të këtyre instrumenteve është i ndaluar të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe personi i autorizuar për verifikimin e instrumenteve matëse.

4. Ngarkohet ministri përgjegjës për ekonominë të nxjerrë rregullore për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse.

Neni 41

Vendimi për autorizim

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë vendos për dhënien e autorizimit brenda 60 ditëve nga aplikimi.

2. Vendimi për autorizim përcakton qëllimin e autorizimit.

3. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë 3-vjeçare.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë cakton markimin (shenjën) verifikuese të një personi të autorizuar për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 42

Revokimi i vendimit për autorizim

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë mund të revokojë autorizimin ose ta reduktojë afatin e tij kur:

a) nuk plotësohen kushtet, për të cilat është dhënë autorizimi dhe nuk kryhen detyrat në mënyrën e përshkruar;

b) cenohen rëndë detyrimet e caktuara në këtë ligj dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij;

c) mbajtësit të autorizimit i kanë ndodhur ndryshime, që e bëjnë të pamundur respektimin e kushteve, për të cilat është dhënë autorizimi.

2. Personi juridik dhe fizik, autorizimi i të cilit është revokuar, sepse ai ka vepruar kundër rregullave, në mënyrë joprofesionale, si dhe në kundërshtim me sa parashikohet në autorizim, nuk mund të aplikojë për një autorizim të ri, brenda një periudhe prej tre vjetësh nga dita që i është revokuar autorizimi.

Neni 43

Pavlefshmëria e autorizimit

Autorizimi bëhet i pavlefshëm kur:

a) mbaron afati i vlefshmërisë;

- b) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ka nxjerrë vendim për revokimin e autorizimit;
- c) i autorizuari heq dorë, me shkrim, nga autorizimi.

Neni 44

Publikimi i vendimit për autorizim

1. Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë nxjerr dhe publikon buletin zyrtar metrologjik me afat 3-mujor.
2. Vendimi për autorizim, ndryshimi i autorizimit dhe mbarimi i vlefshmërisë së tij publikohen në buletin zyrtar metrologjik.

Neni 45

Detyrimet e personit të autorizuar

1. Një person juridik apo fizik i autorizuar duhet:
 - a) të kryejë veprimtarinë e tij profesionalisht dhe në përputhje me rregullat e vendimet për autorizim;
 - b) të njoftojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për mbarimin e autorizimit ose për ndonjë ndryshim të kushteve të autorizimit;
 - c) të mbajë dokumentacion të formave të ndryshme për problemet administrative, që lidhen me qëllimin e autorizimit, në përputhje me rregullat, nëse nuk përshkruhet ndryshe nga ky ligj, ose me rregullat e përshtatura për zbatimin e tij;
 - ç) të japë te Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë informacion të domosdoshëm, brenda afateve të caktuara të përshkruara dhe sipas procedurave të përshkruara, për regjistrimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara në regjistrin përkatës.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përshkruan afatet e caktuara dhe procedurat për dhënien e informacionit për instrumentet matëse të verifikuara.

Neni 46

Metrologu i autorizuar

1. Metrologu i autorizuar kryen verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.
2. Metrologu i autorizuar është një punonjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose personi juridik i autorizuar, që plotëson kushtet e përshkruara për një metrolog të autorizuar.
3. Ministri përgjegjës për ekonominë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, përcakton kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushë kandidati, për t'u kualifikuar si metrolog i autorizuar.

KREU VI INSPEKTIMI METROLOGJIK

Neni 47

Inspektimi metrologjik

Për të kontrolluar (inspektuar) zbatimin e dispozitave detyruese të këtij ligji dhe të rregulloreve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe veprimtarinë e metrologëve të autorizuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë organizohet dhe funksionon Drejtoria e Inspektimit Metrologjik, e përbërë nga specialistë të kësaj drejtorie, të cilët pajisen me një dokument të posaçëm identifikimi dhe quhen inspektorë metrologë.

Neni 48

Plani vjetor i punës

1. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë miraton planin vjetor të punës.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë i raporton ministrit përgjegjës për ekonominë për punën e inspektimit metrologjik, ku i paraqet masat e propozuara për përmirësimin e veprimtarive metrologjike.

Neni 49

Të drejtat e inspektorit metrolog

1. Gjatë inspektimit, inspektori metrolog ka të drejtë të hyjë dhe të inspektojë ndërtesat dhe kushtet e biznesit, ku prodhohen, magazinohen ose përdoren instrumente matëse, si dhe pajisjet, pajisjet e prodhimit dhe makinat. Gjithashtu, gjatë inspektimit, një inspektor metrolog ka të drejtë të hyjë dhe të inspektojë ndërtesat dhe kushtet e biznesit, ku janë prodhuar, importuar dhe ofruar për shitje produktet e parapaketuara dhe shishet, enë matëse.

Gjithashtu, ai ka të drejtë të inspektojë dokumentacionin e biznesit, të çfarëdo forme, për veprimtarinë metrologjike, regjistrimet dhe raportet e testimit të një personi juridik dhe fizik të autorizuar, ose të një metrologu të autorizuar, për të parë se si janë kryer këto veprimtari.

2. Gjatë inspektimit, inspektori metrolog është i autorizuar të kërkojë dhe të inspektojë dokumentet (kartë identiteti, pasaportë etj.), në bazë të të cilave përcaktohet identiteti i personit që inspektohet, i cili është i detyruar t'i vërë ato në dispozicion.

3. Një person juridik dhe fizik i autorizuar dhe persona të tjerë juridikë apo fizikë, veprimtaritë e të cilëve janë subjekt i inspektimit, janë të detyruar ta ndihmojnë inspektorin metrolog për të kryer inspektimin dhe t'i japin atij të dhënat dhe informacionet e domosdoshme. Me kërkesë me shkrim të inspektorit, për të realizuar detyrat e tij, personat juridikë dhe fizikë që inspektohen janë të detyruar të japin ose të përgatisin, brenda një periudhe të caktuar, të dhëna të plota dhe të sakta, informacione dhe regjistrime të nevojshme për kryerjen e inspektimit.

4. Gjatë inspektimit, një inspektor mund të marrë dëshmi nga përfaqësuesit e personit juridik apo fizik dhe dëshmitarët.

5. Për inspektimin e kryer, inspektori metrolog mban një akt inspektimi, ku pasqyrohen të dhënat e marra. Ky akt inspektimi mbahet në dy kopje, njëra prej të cilave i lihet subjektit të inspektuar.

Neni 50

Detyrat e inspektorit metrolog

1. Gjatë inspektimit metrologjik, një inspektor metrolog verifikon:
 - a) ligjshmërinë dhe aftësinë në kryerjen e veprimtarive metrologjike;
 - b) përdorimin e njësive ligjore të matjeve;
 - c) ligjshmërinë dhe autoritetin ligjor në kryerjen e certifikimit të instrumenteve matëse, ekzaminimin e tipit të instrumenteve matëse dhe verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara;
 - ç) përdorimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara;
 - d) konformitetin e parapaketimeve dhe shisheve, enë matëse me masat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij;
 - dh) ligjshmërinë dhe aftësinë në punë të personave juridikë apo fizikë të autorizuar për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
 - e) mënyrën se si mbahen dhe përdoren regjistrimet dhe dokumentet e përshkruara;
 - ë) probleme të tjera kryesore për përcaktimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë dhe të aftësisë në punë, si dhe për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë ligj.
2. Në rastet kur inspektori metrolog vëren shkelje të këtij ligji dhe të rregulloreve të miratuara:
 - a) urdhëron korrigjimin e parregullsive dhe të mangësive të vërejtura brenda një periudhe kohe të specifikuar;
 - b) pezullon përdorimin e instrumenteve matëse dhe hedhjen në treg të paketimeve, që nuk përputhen me kërkesat e përshkruara;
 - c) pezullon kryerjen e veprimtarive, që janë në kundërshtim me ligjin apo me rregullat e zbatuara;
 - ç) pezullon punën e një personi të autorizuar dhe fillon procedurën për refuzimin, revokimin e autorizimit, kur ky nuk plotëson kërkesat metrologjike të përshkruara;
 - d) pezullon punën e një personi të autorizuar apo të një metrologu të autorizuar dhe fillon procedurën për revokimin e autorizimit, kur këta kryejnë veprimtari, për të cilat ato janë autorizuar, në një mënyrë joprofesionale dhe joligjore;
 - dh) për të gjitha shkeljet e konstatuara vendos gjoba në përputhje me nenin 64 të këtij ligji.

Neni 51

Informimi i personit të inspektuar

Inspektori informon subjektin për kryerjen e inspektimit, përveç rasteve kur një gjë e tillë cenon efektivitetin e inspektimit.

Neni 52

Mbështetja e punës së inspektorit

1. Personat juridikë apo fizikë, që janë subjekt i inspektimit metrologjik, janë të detyruar të mbështesin kryerjen e inspektimit, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenet 49 e 50 të këtij ligji dhe të sigurojnë të gjitha kushtet për mbarëvajtjen normale të punës.

2. Vlerësohet se personi juridik apo fizik i inspektuar nuk e ka mbështetur kryerjen e inspektimit, sipas pikës 1 të këtij neni, nëse gjatë periudhës së përcaktuar në raport ai nuk e ka mbështetur inspektorin për të inspektuar (kontrolluar) instrumentet matëse ose

produktet e paketuara, subjekte të inspektimit, si dhe regjistrat e kërkuar të biznesit dhe dokumente të tjera të nevojshme për të marrë e mbledhur fakte.

3. Personat juridikë apo fizikë, sipas pikës 1 të këtij neni, janë të detyruar që, me kërkesë të inspektorit, të ndërpresin përkohësisht veprimtarinë, nëse nuk ka rrugë tjetër për kryerjen e inspektimit.

4. Pas mbarimit të inspektimit, inspektori mund të kërkojë që personi juridik apo fizik i inspektuar të kryejë disa veprimtari që të vendosen plotësisht faktet, duke përcaktuar një afat kohor, gjatë të cilit duhet të kryhet kjo veprimtari.

Neni 53

Ndjekja e parregullive të vëzhguara

Në përfundim të inspektimit, inspektori metrolog informon Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për përfundimet dhe masat e marra për shkeljet e vëna re.

Neni 54

Detyrimet për ruajtjen e sekretit

Inspektori metrolog detyrohet të ruajë sekretin profesional për faktet, informacionet dhe aktet, për të cilat është vënë në dijeni, për shkak të detyrës që kryen. Për shkeljet në këtë drejtim mban përgjegjësi, sipas dispozitave ligjore.

Neni 55

Aplikimi i procedurës së përgjithshme administrative

Procedura e inspektimit është subjekt i masave të procedurave respektive administrative, vetëm nëse disa çështje janë rregulluar ndryshe nga ky ligj.

Neni 56

Plumbosja

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë përcakton procedurat e pumbosjes për rastet kur, në bazë të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, parashikohet detyrimi për plumbosje.

Neni 57

Pavarësia në punë dhe vendimmarrja

Gjatë inspektimit, inspektori duhet të veprojë i pavarur, të drejtojë procedurën, të lëshojë vendime administrative dhe të marrë masa, në përputhje me të drejtat e detyrat e autoriteteve të përcaktuara nga ky ligj dhe me rregullat e përshtatura për zbatimin e tij.

Neni 58

Vendimi për ndalimin e hedhjes në treg apo heqjes nga tregu

1. Kur parregullsitë e vërejtura nuk janë korrigjuar brenda periudhës kohore të specifikuar dhe para se parapaketimet të hidhen në treg, inspektori metrolog, me miratimin paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, mund të nxjerrë një vendim për ndalimin e hedhjes në treg të parapaketimeve.

2. Kur parregullsitë e vërejtura në instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, që janë në treg ose në përdorim, nuk janë korrigjuar brenda periudhës kohore të specifikuar, inspektori metrolog informon Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe nxjerr vendim për bllokimin, largimin nga tregu ose ndalimin e përdorimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 59

Detyrimi për të informuar organet kompetente

Nëse gjatë inspektimit vërehen shkelje, për të cilat me ligj përgjigjen organe të tjera të administratës shtetërore, atëherë Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë njofton organin përkatës.

Neni 60

Nxjerrja e vendimit verbal

1. Kur kryen veprimtari inspektimi, një inspektor metrolog nxjerr një vendim verbal për ekzekutimin e disa masave të sigurisë, kur ka rrezik që evidencat të fshihen, të zhvendosen ose të shkatërrohen, nëse masa e sigurisë nuk merret menjëherë.

2. Inspektori metrolog urdhëron ekzekutim të menjëhershëm të vendimit verbal. Vendimi verbal duhet të shënohet në aktin e inspektimit.

3. Inspektori metrolog është i detyruar të nxjerrë vendim verbal, në formë të shkruar, menjëherë pas kryerjes së inspektimit.

Neni 61

Apelimi

Kundër vendimit të nxjerrë nga inspektori metrolog mund të apelohej në një komision të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

KREU VII

MASAT FINANCIARE

Neni 62

Mënyrat e financimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, me të ardhurat nga veprimtaria e saj, mbulon shpenzimet dhe diferenca ndërmjet tyre financohet nga shteti në formën e granteve ose të subvencioneve financiare dhe administrimi i fondeve i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për institucionet buxhetore.

2. Mënyra e përdorimit të të ardhurave të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë nga shërbimet e saj përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për ekonominë, të propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Neni 63

Pagesat dhe tarifat e shërbimeve

1. Kalibrimi, certifikimi i materialeve referuese, miratimi i tipit, verifikimi fillestar, pasardhës dhe jashtë radhe, i instrumenteve matëse, miratimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve dhe të shisheve, si enë matëse, ekspertiza metrologjike, autorizimi për verifikim dhe shërbim riparimi, si dhe trajnimet e ofruara kryhen kundrejt tarifave të miratuara. Këto tarifa miratohen nga Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për ekonominë. Tarifat janë të njëjta si për subjektet vendase, ashtu dhe ato të huaja, që ushtrojnë veprimtari prodhimi ose shërbimi në Republikën e Shqipërisë.

2. Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe laboratorët e etaloneve kombëtare, jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për kryerjen e shërbimeve të ndryshme, përdorin tarifa të miratuara nga Ministria e Financave.

KREU VIII

KUNDËRVAJTJET DHE SANKSIONET

Neni 64

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

Kur inspektorët metrologë vërtetojnë se subjekti ka shkelur dispozitat e këtij ligji, kanë të drejtë të vendosin gjobë, sipas pikave 1, 2 e 3 të këtij neni dhe të kërkojnë nga subjekti marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur afat për realizimin e saj.

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

1. Për subjektet e biznesit të vogël 30 000 lekë dhe për subjektet e biznesit të madh 150 000 lekë:

a) përdorimi i njësive matëse në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 11 të këtij ligji;

b) mbajtja në biznesin e vet të një instrumenti matës që nuk është në përdorim dhe nuk është shënuar në mënyrë të dukshme me shenjën “Instrument matës jashtë përdorimit”, pika 2 e nenit 20 të këtij ligji;

c) mossigurimi i verifikimit periodik të instrumenteve matëse në intervalet e përshkruara në shkronjën “c” të nenit 21 të këtij ligji;

ç) mosvënia në dispozicion e instrumenteve matëse pas riparimit për verifikim periodik, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 29 të këtij ligji;

d) mosplotësimi i kërkesave për regjistrim, të përshkruara në nenin 38 të këtij ligji.

2. Për subjektet e biznesit të vogël 60 000 lekë dhe për subjektet e biznesit të madh 400 000 lekë:

a) mosmirëmbajtja e rregullt e instrumenteve matëse, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 23 të këtij ligji;

b) prodhimi, importimi dhe hedhja në treg e produkteve të paketuara dhe shisheve, enë matëse, që nuk plotësojnë kërkesat metrologjike dhe nuk kanë mbishkrimet dhe shenjat e përshkruara, sipas pikës 1 të nenit 37 të këtij ligji;

c) veprimi në kundërshtim me dispozitat e përshkruara në nenet 42 pika 1 dhe 45 të këtij ligji;

ç) veprimi në kundërshtim me dispozitat e përshkruara në pikën 3 të nenit 49 të këtij ligji.

3. Për subjektet e biznesit të vogël 100 000 lekë dhe për subjektet e biznesit të madh 750 000 lekë:

a) hedhja në treg dhe vënia në përdorim e instrumenteve matëse në kundërshtim me dispozitat e përshkruara në pikën 1 të nenit 19 të këtij ligji;

b) përdorimi i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara në kundërshtim me dispozitat e përshkruara në pikën 3 të nenit 20 të këtij ligji;

c) veprimi në kundërshtim me dispozitat e përshkruara në pikën 1 të nenit 21 të këtij ligji;

ç) mosdhënia e informacionit dhe e të dhënave të domosdoshme inspektorit metrolog për të kryer inspektimin, në kundërshtim me dispozitat e pikës 3 të nenit 49 të këtij ligji;

d) veprimi në kundërshtim me dispozitat e nenit 51 të këtij ligji.

Në raste përsëritjeje të së njëjtës kundërvajtje, vlera e gjobës dyfishohet.

Neni 65

Shqyrtimi dhe ankimi

1. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative dhe ankimi i vendimeve bëhen sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

2. Kundër vendimit të dënimit me gjobë, të dhënë nga inspektori metrolog i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, mund të bëhet ankimi brenda 15 ditëve te Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, i cili brenda 15 ditëve duhet të bëjë shqyrtimin e ankimit.

3. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë mund të bëhet ankimi në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e dhënies së vendimit.

Neni 66

Ekzekutimi

Gjoha i dërgohet për ekzekutim zyrtarisht brenda 30 ditëve nga data e vendimit të formës së prerë bashkisë ose komunës, ku kundërvajtësi ka vendbanimin ose kryen veprimtarinë kryesore.

Të ardhurat e arkëtuara nga gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

KREU IX
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 67

Miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, ministria përgjegjëse për ekonominë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 68

Shfuqizimet

Ligji nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”, shfuqizohet.

Neni 69

Hyrja në fuqi

Nenet 35 deri 39, që formojnë pjesën III “Produktet e paketuara dhe shishet, enë matëse” të kreut V “Metrologjia ligjore” të këtij ligji, zbatohen një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 70

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)